


Cilat janë shkaqet e transferimit të përhershëm?

Transferimi i përhershëm realizohet për shkak të:

- Gjendjes së paaftësisë shëndetësore të nëpunësit për të kryer detyrat;
- Shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, sipas nenit 52 të ligjit;
- Përfundimit të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit të nëpunësit civil dhe pozicioni që mbante në momentin e pezullimit është plotësuar sipas ligjit;
- Ristrukturimit të institucionit.



TRANSFERIMI NË SHËRBIMIN CIVIL



042 26 8141



info@kmsmc.al;
kmsmc@kmsmc.al



Rruga: "Abdi Toptani",
ish-hotel "Drini", Tiranë



www.kmsmc.al

Cilat janë shkaqet e refuzimit të transferimit?

Nëpunësi civil për të cilin njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e transferimit, ka të drejtë të refuzojë transferimin vetëm për shkaqet e mëposhtme:

- Kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur.
- Nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil.
- Refuzimi i transferimit në çdo rast tjetër përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil.

Si përkufizohet transferimi?

Transferimi në shërbimin civil nënkupton procesin e caktimit në mënyrë të përkohshme ose të përhershme të nëpunësit civil nga një pozicion në një tjetër pozicion të shërbimit civil. Transferimi mund të jetë i përkohshëm ose i përhershëm.

Çfarë kuptojmë me transferim të përkohshëm?

Transferimi i përkohshëm është caktimi i nëpunësit civil përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil brenda të njëjtës kategori. Transferimi i përkohshëm mund të jetë brenda të njëjtës institucion ose në një institucion tjetër për arsye të institucionit, përmirësim të rezultateve në punë, apo paaftësi e përkohshme shëndetësore.

Çfarë kuptojmë me transferim të përhershëm?

Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozicion tjetër të shërbimit civil. Transferimi i përhershëm mund të jetë për arsye shëndetësore, arsye të konfliktit të interesit ose si pasojë e ristrukturimit të institucionit. Transferimi i përhershëm bëhet me kërkesë të nëpunësit civil ose me kërkesë të eprorit apo njësisë së burimeve njerëzore.

Në çfarë pozicioni pune mund të transferohet përkohësisht nëpunësi civil?

Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rastit përkatësisht:

- brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale,
 - në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar,
 - në një institucion tjetër të shërbimit civil
- Cilat janë shkaqet e transferimit të përkohshëm?

Transferimi i përkohshëm realizohet për:

- Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve.
- Për përmirësimin e rezultateve të tij, deri në 3 (tre) muaj pa ndërprerje gjatë 2 viteve.
- Për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë.